



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2505/ 4 Prot.,

Datë 30.09.2025

V E N D I M

Nr. 1363/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga ”shpk në procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos. Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Shaga ”shpk, Nipt J96822229J, me adresë: *Rruga: “Hamdi Pepa”, ish Parku i Industrisë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos, me adresë: *Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4,

i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10-09-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit me “E hapur, e thjeshtuar”, “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datën 16.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5808, protokolluar me nr. 2505/2025 prot, datë 16.09.2025, e operatorit ekonomik “SHAGA ”shpk, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit. Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

...[ *Kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktor për dorëzimin e mostrave për më shumë se gjysmën e produkteve të preventivit ...*

*Prandaj, kërkohet shfuqizimi ose korrigjimi i menjëhershëm i këtij kriteri për të garantuar zbatimin e ligjit dhe për të ruajtur integritetin e procedurës së prokurimit publik,.....].*

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr.2826/5 prot, datë 24.09. 2025 protokolluar me tonën autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur shkresën me objekt “Vënie në dijeni rreth vendimit të shqyrtimit të ankesës”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga”shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit ku ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Nëpërmjet shkresës me nr.2826/5 prot, datë 24.09. 2025 protokolluar me tonën autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur shkresën me objekt “Vënie në dijeni rreth vendimit të shqyrtimit të ankesës”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga”shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit ku ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës.

Vendosi :

\*\*\*

[...sa më sipër KSHA gjykon se kërkesa për dorëzim të mostrave duhet të kufizohet vetëm për mallrat:

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm	cope	1
2	Karriget e zones se lojes (30x60)cm	cope	1
6	Krevate (125x65)cm	cope	1
7	Dysheke per krevatet e femijeve	cope	1
8	Jasteke per krevatet e femijeve	cope	1
17	Karrige statike metalike	cope	1

Për sa më sipër pretendimi Juaj qëndron pjesërisht.

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një

*prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.*

*3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

*a) pranimin e plotë të ankesës;*

*b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*

*c) refuzimin e ankesës.*

*4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

*5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.*

*6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me nr. 2826/5 prot., datë 24.09.2025 si dhe protokolluar me tonën nr. 2505/1 prot, datë 26.09. 2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, kthim -përgjigje për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Shaga” shpk nga autoriteti kontraktor, rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin e pjeshëm të ankesës.

KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues , për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga” shpk dhe të vijojë shqyrtimin e ankesës, për pjesën e mbetur të saj.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, për sa i përket modifikimit te kriterit 2.3.4, lidhur me artikujt si në vijim:

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm	cope	1
2	Karriget e zones se lojes (30x60)cm	cope	1
6	Krevate (125x65)cm	cope	1
7	Dysheke per krevatet e femijeve	cope	1

8	Jasteke per krevatet e femijeve	cope	1
17	Karrige statike metalike	cope	1

, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 7 “ Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” dhe shtojcën 8 seksioni “ Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

**2.3.4** *Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambientet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 22/09/2025 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:*

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm	cope	1
2	Karriget e zones se lojes (30x60)cm	cope	1
6	Krevate (125x65)cm	cope	1
7	Dysheke per krevatet e femijeve	cope	1
8	Jasteke per krevatet e femijeve	cope	1
13	Tavoline per zyren e drejtorit, psikologut dhe infermierit(130x80x75)cm	cope	1
17	Karrige statike metalike	cope	1
18	Frigorifer (65x200x60) 350L+	cope	1
19	Lavastovilje inkaso (65x85x55)	cope	1
20	Aspirator inkaso me shine (60x40) cm	cope	1
21	Lavatrice 9kg (60x85x65)	cope	1
22	Tharese rrobash 8kg (60x85x65)cm	cope	1
23	Lavapjate inoksi me dy ndarje (116x22x50)+Rubinet inoksi	cope	1
24	Pianure	cope	1

*Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.*

**Shënim:** *Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

**Shtojca 7.**

**Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm	cope	21
2	Karriget e zones se lojes (30x60)cm	cope	120
3	Raft pranimi (330x40x125)cm	cope	6
4	Raft per vendosjen e lodrave (460x30x55)cm tip 1	cope	6
5	Raft per vendosjen e lodrave (250x40x100)cm tip 2	cope	6
6	Krevate (125x65)cm	cope	100
7	Dysheke per krevatet e femijeve	cope	100
8	Jasteke per krevatet e femijeve	cope	100
9	Dollap per dhomat e gjumit (240x40x220)cm	cope	6
10	Mobilje per zonen lavanterise (270x60x250)cm	cope	1
11	Bufe per Guzhinen (700x60x250)cm	cope	1
12	Tavoline per guzhinen (180x80x75)cm	cope	1
13	Tavoline per zyren e drejtorit, psikologut dhe infermierit(130x80x75)cm	cope	3
14	Dollap tek me 2 kanata per zyren e drejtorit, psikologut dhe infermierit(250x40x100)cm	cope	3
15	Raft i montuar ne mur per zyren e drejtorit dhe psikologut (160x40x105)cm	cope	2

16	Krevat Ekzaminimi per zyren e infermierit (190x60x68)cm	cope	1
17	Karrige statike metalike	cope	12
18	Frigorifer (65x200x60) 350L+	cope	1
19	Lavastovilje inkaso (65x85x55)	cope	1
20	Aspirator inkaso me shine (60x40) cm	cope	1
21	Lavatrice 9kg (60x85x65)	cope	1
22	Tharese rrobash 8kg (60x85x65)cm	cope	1
23	Lavapjate inoksi me dy ndarje (116x22x50)+Rubinet inoksi	cope	1
24	Pianure	cope	1

#### Afatet e lëvrimit:

1 (një) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shënim:

III.2.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE dokumentin: “Proces-Verbal Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, Argumentim mbi Specifikimet Teknike Objekti i procedurës: “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë”.

2.3.4... [ Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 22/09/2025 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
----	----------	--------	-------

1	Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm	cope	1
2	Karriget e zones se lojes (30x60)cm	cope	1
6	Krevate (125x65)cm	cope	1
7	Dysheke per krevatet e femijeve	cope	1
8	Jasteke per krevatet e femijeve	cope	1
13	Tavoline per zyren e drejtorit, psikologut dhe infermierit(130x80x75)cm	cope	1
17	Karrige statike metalike	cope	1
18	Frigorifer (65x200x60) 350L+	cope	1
19	Lavastovilje inkaso (65x85x55)	cope	1
20	Aspirator inkaso me shine (60x40) cm	cope	1
21	Lavatrice 9kg (60x85x65)	cope	1
22	Tharese rrobash 8kg (60x85x65)cm	cope	1
23	Lavapjate inoksi me dy ndarje (116x22x50)+Rubinet inoksi	cope	1
24	Pianure	cope	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

**Shënim:** Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

.../.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe 7 personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në Nenin 92 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit.

III.2.7. Në pikën 6 të nenit 40 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose. [...] 38 të këtij ligji.

III.2.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të

përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt – prokurimi.

III.2.9. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, gjithashtu pretendimit të operatorit ekonomik ankimues ku kërkon shfuqizimin ose korrigjimin i menjëhershëm i këtij kriteri, “ *Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 22/09/2025 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë: 1.Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm cope 1; 2. Karriget e zones se lojes (30x60)cm cope 1;6 Krevate (125x65)cm cope 1; 7. Dysheke per krevatet e femijeve cope 1;8 Jasteke per krevatet e femijeve cope 1; 13. Tavoline per zyren e drejtorit, psikologut dhe infermierit(130x80x75)cm cope 1; 17. Karrige statike metalike cope 1; 18. Frigorifer (65x200x60) 350L+cope 1;19. Lavastovilje inkaso (65x85x55)cope 1; 20. Aspirator inkaso me shine (60x40) cm cope 1; 21. Lavatrice 9kg (60x85x65) cope 1; 22. Tharese rrobash 8kg (60x85x65)cm; 23. Lavapjate inoksi me dy ndarje (116x22x50)+Rubinet inoksi cope 1; 24 Pianure cope 1, si dhe argumentimit te autoritetit kontraktor me shkresën nr. 2826/5 datë 24.09.2025 ku bashkëlidhur saj ka përcjellë dhe shkresën me nr. 2821/3 prot., datë 24.09.2025, nga rezulton se autoriteti kontraktor ka gjykuar se kërkesa për dorëzimin e mostrave, do të kufizohet vetëm për artikujt: 1.Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm; 2. Karriget e zones se lojes (30x60)cm;6 Krevate (125x65)cm; 7. Dysheke per krevatet e femijeve cope 1;8 Jasteke per krevatet e femijeve; 17. Karrige statike metalike, kjo e bazuar në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit të mallrave të kërkuar shtojca 7 të DST.*

III.2.10 Komisioni gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë

teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave lidhur me artikujt: 1. *Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm*; 2. *Karriget e zones se lojes (30x60)cm*; 6 *Krevate (125x65)cm*; 7. *Dysheke per krevatet e femijeve cope 1*; 8 *Jasteke per krevatet e femijeve*; 17. *Karrige statike metalike*, është në përputhje me nenin 40 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndaj kjo kërkesë për dorëzimin e mostrave për artikujt që autoriteti percakton se kanë me shume rendesi nuk eshte e ekzagjeruar dhe se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, me përdorueshmëri më të lartë për institucionin, në rastin në fjalë nga (24) artikujt që do të prokurohen, mostrat do të kerkohen vetem per (6) artikujt konkretisht: 1. *Tavolina e zones se lojes D=120cm, H=57cm*; 2. *Karriget e zones se lojes (30x60)cm*; 6 *Krevate (125x65)cm*; 7. *Dysheke per krevatet e femijeve cope 1*; 8 *Jasteke per krevatet e femijeve*; 17. *Karrige statike metalike*; me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, me të drejtë autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kërkesa për dorëzimin e mostrave duhet kufizuar vetëm për artikujt të cilat janë me përdorim të lartë në institucion.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik”, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik nga “Shaga” shpk për procedurën e prokurimit në procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shaga” shpk për procedurën e prokurimit për procedurën e prokurimit në procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, Nr. REF-60671-09-09-2025, me objekt “Blerje mobilje dhe pajisje për kopështin me drekë” me fond

limit 6,663,000.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 22-09-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Shaga" Shpk .

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

